

Komuna e Shtimes
Opština Shtime
Municipality of Shtime

15/07/2024
02/780



Bashkesia Islame e Kosovës
Këshilli i Bashkësisë Islame, Shtime

Komuna e Shtimes e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Qemajl Aliu, në tekstin në vijim:
(Komuna)

dhe

Këshilli i Bashkësisë Islame, përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Shtime, z. Skender Baftiu.

Në kuadër të autorizimeve përkatëse, sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve që varrosen në territorin e Komunës së Shtimes, me Nr. NPI-01/162 të datës 27.04.2023, e cila nuk përmban afat kohor të vlefshmërisë, palët lidhin këtë vazhdim të:

MARREVESHJE MIRËKUPTIMI PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHERBIMET E VARRIMIT

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj Marreveshje është që Komuna e Shtimes të subvencionojë kryerjen e shërbimeve të varrimit për qytetarët që varrosen në territorin e Komunës së Shtimes, në shumë prej 250 € (dyqind e pesëdhjete euro) për secilin rast të vdekjes, përmes Këshillit të Bashkësisë Islame në Shtime, i cili kryen shërbimet e varrimit sipas rregullave dhe traditave përkatëse, konform Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. NPI-01/162 të datës 27.04.2023.



Neni 2

Lënda

1. Shërbimet e varrimit përfshijnë: lajmerimet, pastrimin e kufomës, qefinin, mbulesën e kufomës, dërrasat, piramidën, hapjen e varrit dhe kryerjen e riteve fetare (banjo, kujdestaria, transporti i kufomes brenda territorit të komunes, mjete higjienike).
2. Subvencionimi i shërbimeve të varrimit, sipas kësaj Marrëveshje në asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me pagesën e anëtarësisë ndaj Bashkësisë Islame. Anëtarësia në raportin Xhemat KBI, mbetet si në të kaluarën.

Neni 3

Obligimet e Bashkësisë Islame

1. Keshilli i Bashkësisë Islame, në baza mujore, më së largu me datën 5 të muajit vijues, parashtron kërkesën për kompenzim të shërbimeve përkatëse, të cilën kërkesë ia drejton Zyrës së Kryetarit të Komunës.
2. Kërkesës së cekur në paragrafin e parë duhet t'i bashkëngjitet:
 - 2.1. Registri i personave të vdekur për muajin përkatës;
 - 2.2. Certifikata e numrit fiskal;
 - 2.3. Konfirmimi i logarisë bankare;
 - 2.4. Aktvendimi i Arkatarit;
 - 2.5. Kopja e letërnjoftimit të Arkatarit.
3. Marrëveshja është e vlefshme nga muaji Korrik 2024 deri në Dhjetor 2024. Komuna ka të drejtën që të kërkojë edhe dokumente të tjera, që i konsideron si të nevojshme për shqyrtimin dhe përfundimin e kërkesës së cekur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 4


Obligimet e Komunës së Shtimes

1. Komuna e Shtimes, duke u bazuar në kërkesën dhe dokumentacionin tjetër të bashkëngjitur me Vendim të Kryetarit të Komunës, nëpërmjet Zyrtarit Kryesor Financiar, ekzekuton pagesën më së largu brenda afatit 10 ditë (ditë pune) nga dita e pranimit të kërkesës në kushte dhe rrethana normale.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët pajtohen në mes veti që në rast të paraqitjes të ndonjë mosmarrëveshje gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, çështjet të zgjidhen me dialog dhe mirekuptim, e në rast se përsëri nuk ka dakordim, mosmarrëveshjet do të zgjidhen në Gjykatën kompetente.



Neni 6
Numri i kopjeve

Marrëveshja e Mirëkuptimit nënshkruhet në tre kopje origjinale dhe nga një kopje mbetet për secilen pale nënshkruese, kurse një kopje për arkiv.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

z. Qemajl Aliu
Kryetar i Komunës së Shtimes



z. Skender Baftiu
Kryetar i Baskësisë islame në Shtime

